



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**A nr. 726/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Xhevdet Abazi kryesues, Muharrem Shala dhe Muhamet Rexha anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Podujevë, paraqitur kundër Komisionit Qendror Zgjedhor (KQZ), për shkak te mungesës së votave për zgjedhjet lokale të datës 03 Nëntorit 2013, në seancën e panelit të mbajtur me 08.11.2013, mori këtë:

### V E N D I M

**HIDHEN** si të palejueshme ankesat: Anr.726/13, Anr.727/13, Anr.728/13, Anr.729/13, Anr.730/13, Anr.731/13, Anr.732/13, Anr.733/13, Anr.734/13, Anr.735/13, Anr.736/13, Anr.737/13, Anr.738/13 të datës 06.11.2013, te subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Podujevë.

### Arsyetim

PZAP-i, ka pranuar ankesat: Anr.726/13, Anr.727/13, Anr.728/13, Anr.729/13, Anr.730/13, Anr.731/13, Anr.732/13, Anr.733/13, Anr.734/13, Anr.735/13, Anr.736/13, Anr.737/13, Anr.738/13 me datë 06.11.2013, nga subjekti politik PDK dega në Podujevë si dhe një shkresë përmbledhëse të ankesave të sipërshenuar në të cilën pretendohet se pas publikimit të rezultateve preliminare nga KQZ-ja, për komunën e Podujevës, kemi vërejtur shumë pasaktësi, të cilat kanë ndikuar drejtpërdrejtë në rezultatin e publikuar, këtë e vërtetojmë duke e bërë krahasimin nëpërmjet Formularit të Përputhjes së të dhënave dhe Rezultateve (FPR). Sipas parashtruesit të ankesave, nga rezultatet e publikuara në mënyrë elektronike nga KQZ-ja, kanë konstatuar se ekziston një dallim shumë i madh që ndikon drejtpërdrejtë në rezultatin e publikuar.

- Në ankesën Anr.726/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në Qendrën e Votimit (QV) 1824E/04R, është bërë ndryshimi i të dhënave në FPR, për numërimin e votave nga personi i KQZ-së. Pasi që pretendohet se në rezultatin preliminar numëri i LVP-së është 401, në FPR për kryetar është 404. Nga rezultati i publikuar nga KQZ-ja për PDK-në janë 145 vota, ndërsa nga FPR numëri i votave është 146 vota.
- Në ankesën Anr.727/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1824E/12D, është bërë ndryshimi i të dhënave FPR për numërimin e votave nga personi i KQZ-së. Pasi që pretendohet se numëri i nënshkrimeve në LVP të KQZ-së është

351, ndërsa në FPR për kryetar janë 284 vota. Pra LDK-ja i ka 173 vota dhe duhet ti ketë 151 vota, ndërsa PDK-ja i ka 120 vota dhe duhet ti ketë 106 vota.

- Në ankesën Anr.728/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1831E/02D, është bërë ndryshimi i të dhënave në FPR për numërimin e votave nga personi i KQZ-së. Nga rezultati i dhënë nga KQZ-ja pretendohet se numëri i nënshkrimeve në LVP është 220 ndërsa në FPR për kryetar komune është 220. në rezultatin e publikuar koalicioni AAK-LDD e ka 1 votë, ndërsa në FPR i ka 3 vota, AKR-ja e i ka 0 vota ndërsa në FPR e ka 1 votë.
- Në ankesën Anr.729/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1829E/01R, është bërë ndryshimi i të dhënave në FPR, për numërimin e votave nga personi i KQZ-së. Nga rezultati i KQZ-së pretendohet numëri i nënshkrimeve të LVP-së është 674, ndërsa në FPR për kryetar është 371 vota. Në rezultatin preliminarë të KQZ-së në FPR koalicioni AAK-LDK i ka 09 vota dhe duhet ti ketë 32 vota ndërsa LDK-ja i ka 316 vota andaj duhet ti ketë 179 vota , AKR-ja i ka 04 vota dhe duhet ti ketë 01 votë, PDK-ja i ka i ka 281 vota dhe duhet ti ketë 158 vota dhe LB-ja i ka 04 vota dhe duhet ti ketë 03 vota.
- Në ankesën Anr.730/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1824E/09R, është bërë ndryshimi i të dhënave në formular. Mirëpo pretendohet se numëri i nënshkrimeve në LVP është 360 dhe duhet të jetë 365. Pra LVV-ja i k 17 vota dhe duhet ti ketë 20 vota,koalicioni AAK- LDD i ka 10 vota deri në 15 vota, LDK-ja i ka 178 deri në 181 vota dhe PDK-ja i ka 149 deri në 141 vota.
- Në ankesën Anr.731/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1824E/07R, është bërë ndryshimi i të dhënave në FPR për kryetar të komunës. Mirëpo pretendohet se votat për PDK janë 151 andaj duhet të jenë 152 vota .
- Në ankesën Anr.732/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1824E/11R, është bërë ndryshimi i të dhënave ne FPR në lidhje me numërimin e votave nga personi i KQZ-së. Në rezultatin e dhënë pretendohet se numëri i nënshkrimeve në LVP është 277 ndërsa në FPR për kryetar komune është 355 nënshkrime. Nga rezultati i publikuar nga KQZ-ja theksohet se LVV-ja i ka 11 vota ndërsa duhet ti ketë 21 vota, koalicioni AAK –LDD i ka 07 vota dhe duhet ti ketë 27 vota, LDK-ja i ka 151 vota dhe duhet ti ketë 173 vota, PDK-ja i ka 106 andaj duhet ti ketë 122 vota dhe LB –ja duhet ti ketë 02 vota ndërsa duhet ti ketë 03 vota .
- Në ankesën Anr. 733/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se rezultatet preliminare të publikuara nga KQZ-ja, nuk përputhen me rezultatet e formularëve për kuvendin komunal ne nëntë vendvotimet e cekura me nr. 1824E/04R, 1824E/01R, 1824E /07R, 1824E/02R, 1824E/11R, 1824E/12D, 1803E/01R, 1824E/10R 1817E/02R.
- Në ankesën Anr.734/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1840E/01D bazuar në rezultatin e KQZ-së, dhe formularit për anëtar të kuvendit komunal, del se ka shumë parregullsi në numërimin e votave. Nga rezultatet e KQZ-së për

anëtar të kuvendit komunal pretendohet se janë si vijon : PAI- ja i ka 106 vota deri sa PDK-ja i ka 26 vota. Pra në këtë regjion nuk ka votues të komunitetit shkali por votat e PDK-së i janë bartur PAI-së ndërsa votat e LB-së i janë dhënë PDK-së, pra nga ky rast edhe LB-së i janë marrë votat.

- Në ankesën Anr.735/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se për QV 1824E/08R, për anëtar të kuvendit komunal, rezultatet e publikuara nga KQZ-ja janë jo të drejta dhe te pa rregullta. Pasi që për anëtar të kuvendit komunal pretendohet se nënshkrimet e LVP-së janë 411 ndërsa sipas FPR duhet të jenë 419 . Numëri i votave të supozuara nga parashtruesi i ankesës është si vijon : LVV i ka 30 ndërsa duhet ti ketë 50 vota, koalicioni AAK-LDD i ka 45 vota dhe duhet ti ketë 33 vota, PD-ja i ka 09 vota dhe duhet ti ketë 04 vota LDK-ja i ka 180 vota dhe duhet ti ketë 146 vota, AKR-ja i ka 02 vota dhe duhet ti ketë 21 vota, PDK-ja i ka 102 dhe duhet ti ketë 120 vota, LB-ja i ka 17 vota dhe duhet ti ketë 03 vota, PDAK-ja i ka 10 vota dhe duhet ti ketë 0 vota.
- Në ankesën Anr.736/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se për QV 1824E/09R, rezultatet preliminare të publikuara nga KQZ-ja janë të parregullta, sa i përket numërimit të votave dhe nënshkrimeve për kuvendin komunal, bazuar në FPR. Nga numëri i votave të pasqyruara për kuvend komunal pretendohet se LVV-ja i ka 20 ndërsa duhet ti ketë 35, koalicioni AAK-LDD i ka 18 vota ndërsa duhet ti ketë 25 vota, PD-ja i ka 08 vota ndërsa duhet ti ketë 02 vota, LDK-ja i ka 165 vota ndërsa reale duhet ti ketë 138 vota, AKR-ja i ka 02 vota reale ndërsa duhet ti ketë 15 vota, PAI i ka 02 vota ndërsa duhet ti ketë 05 vota, PDK-ja i ka 102 vota dhe duhet ti ketë 115 vota, LB-ja i ka 09 vota dhe duhet ta ketë 01 votë , PDAK-ja i ka 06 vota dhe Sërpska i ka 03 vota.
- Në ankesën Anr.737/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1804E/03D, për kuvend komunal nga rezultatet e shpallura nga KQZ-ja ka shumë pa rregullsi, prandaj kërkojmë që ky vendvotim të rinumërohet. Prandaj nga rezultatet e pretendohet se në FDHR-së për kuvendin komunal del se, subjektet politike PAI i ka 55 vota deri sa PDK-ja i ka nuk ka asnjë votë, prandaj në këtë regjion nuk ka asnjë ashkali dhe kërkojmë që të rinumërohet ky vendvotim.
- Në ankesën Anr.738/13 të datës 06.11.2013, pretendohet se në QV 1824E/05R, sipas rezultateve të publikuara nga KQZ-ja, kanë ndodhur shumë pa rregullsi në shumë vendvotime. Sipas numërit të nënshkrimeve në LVP është 407, ndërsa në FPR është 419. Pra numëri i votave të pretenduara është si vijonë: LVV-ja i ka 25 vota ndërsa duhet ti ketë 32 vota, koalicioni AAK-LDD i ka 60 vota ndërsa duhet ti ketë 40 vota, PD-ja i ka 21 vota dhe duhet ti ketë 04 vota, LDK-ja i ka 180 vota ndërsa duhet ti ketë 181 vota, AKR-ja i ka 40 vota ndërsa duhet ti ketë 12 vota, PAI- ja e ka 1 votë, ndërsa duhet ti ketë 03 vota, PDK-ja i ka 62 vota ndërsa duhet ti ketë 112 vota, LB -ja i ka 13 vota ndërsa duhet ti ketë 05 vota, PDAK- ja i ka 04 vota ndërsa duhet ti ketë 0 vota.

Bazuar ne nenin 6.3 të “Rregullave dhe Procedurave” të PZAP-it, në të cilin parashihet se: “Me qëllim të lehtësimit të shqyrtimit të ankesave, Kryesuesi i Panelit mund të vendos ta bëjë bashkimin e ankesave që përmbajnë në vete çështje të ngjashme, paneli vendim-marrës i trajton ato ankesa sikurse të ishin një ankesë”. Në rastin konkret Kryesuesi i Panelit duke u bazuar në dispozitën ligjore të lartcekur ka vendosur ti bashkoi ankesat e sipërshënuara dhe ti trajtoi si një ankesë.

PZAP-i, shqyrtoi lejueshmërinë e ankesave, gjeti se:

### **Ankesat janë të palejuara**

PZAP-i, konstatoi se ankesat janë të palejuar ngase rezultati preliminarë i shpallur nga KQZ-ja nuk është përfundimtar dhe mund të ndryshoj në çdo moment kjo vërtetohet edhe nga shkresa e KQZ-së me nr. 1531/A-2013 e datës 07.12.2013 në të cilën theksohet se: “materiali zgjedhor është duke u proceduar sipas procedurave të brendshme të Qendrës së Numërimit dhe Rezultateve (QNR) dhe deri në përfundimin e këtij procesi nuk mund të vërtetohet saktësia e pretendimeve ankimore”

Ankesat në fjalë për rezultat preliminarë në vendvotim është dashtë të parashtrohet në PZAP nga anëtarët e komisionit të vendvotimit sipas nenit 102.1 të LZP-së i cili parasheh “Çdo anëtarë o komisionit të Vendvotimit që ka vërejtje në rezultatet e shënuara në një vendvotim mund të regjistroj mospajtimin tij në librin e votimeve të vendvotimit dhe mund të dërgoj një vërejtje te Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa në përputhje me këtë ligj”.

Në rastin konkret ankesat janë parashtruar nga kryesia e subjektit politik PDK në Podujevë, nga kjo del se, ankesat në fjalë duke u bazuar në dispozitën e sipërshënuar nuk janë të autorizuar të parashtrojnë ankesa të kësaj natyre në këtë fazë të procesit zgjedhor.

Bazuar në arsyet e sipërshënuar dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së i cili parasheh se “PZAP-i, pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk i përmbushin standardet” dhe nenit 4.2 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, në të cilin përcaktohet se: “PZAP-i, mund të hidh poshtë (si të palejuar, të parregullta apo të pa afatshme) ankesat, të cilat nuk i plotësojnë kriteret e parapara në nenin 3 të këtyre rregullave dhe procedurave, po ashtu PZAP refuzon ankesat të cilat janë të pabazuara, apo të cilat janë në përputhje me dispozitat e duhura ligjore”, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

A nr. 726/2013 më datën 08.11.2013



**Kryesuesi i Panelit**

**Xhevdet Abazi**

**Këshillë juridike:** Ndaj këtij vendimi siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.